



Kriteri i punës për të rriturit e moshave 18 deri në 49 vjeç **THE WORK REQUIREMENT FOR ADULTS AGES 18 THROUGH 49**

Cili është kriteri i punës për të rriturit e moshave 18 deri në 49 vjeç?

Është kriter federal që duhet plotësuar nga disa anëtarë të FoodShare-it me qëllim që të vazhdojnë të marrin përfitime FoodShare. Ka të bëjë me të rritur të moshave 18 deri në 49 vjeç të cilët nuk kanë fëmijë nën moshën 18 vjeç që jetojnë në shtëpinë e tyre dhe që nuk përbëjnë përjashtim.

Si mund ta plotësoj kriterin e punës?

Ekzistojnë tri mënyra për të plotësuar kriterin e punës:

1. Të punoni të paktën 80 orë në muaj.
2. Të merrni pjesë në një program pune të lejueshëm për të paktën 80 orë çdo muaj, të tillë si:
 - Trajnimi dhe punësimi FoodShare (FSET).
 - Wisconsin Works (W-2).
 - Programe të caktuara sipas Workforce Innovation and Opportunity Act (WIOA).
3. Edhe të punoni edhe të merrni pjesë në një program pune të lejueshëm për një total të kombinuar prej të paktën 80 orësh çdo muaj.

Në qoftë se jam i rritur që duhet të plotësoj kriterin e punës, kur duhet të filloj ta plotësoj atë?

Duhet të filloni ta plotësoni kriterin e punës në muajin e parë të plotë kur merrni përfitimet FoodShare. Kur aprovohet një aplikim FoodShare, çdo person në aplikim që duhet të plotësojë kriterin e punës rekomandohet për programin FSET.

Cilët të rritur nga moshën 18 deri në 49 vjeç përjashtohen nga kriteri i punës?

Mund të bëhet përjashtim për ju dhe mund të mos ju duhet që të plotësoni kriterin e punës në qoftë se ndonjë nga pikat e mëposhtme është e vërtetë:

- Jetoni me një fëmijë nën moshën 18 vjeç i cili bën pjesë në të njëjtën familje që merr FoodShare.
- Jeni kujdestari kryesor për një person i cili nuk mund të kujdeset për veten e tij ose saj.
- Jeni kujdestari kryesor për një fëmijë të ndërvarur nën moshën 6 vjeç.
- Nuk mund të punoni për arsye fizike ose mendore. Këtu përfshihet rasti kur jeni pa strehë për një kohë të gjatë. Të qenit pa strehë për një kohë të gjatë do të thotë se nuk keni një vend të zakonshëm ku të qëndroni gjatë 30 netëve të ardhshme.
- Jeni shtatzënë.
- Po merrni ose keni aplikuar për sigurim papunësie.
- Po merrni pjesë në një program trajtimi ose rehabilitimi për abuzimin me alkoolin ose abuzimin me ndonjë drogë tjetër (AODA).
- Jeni regjistruar në një institucion të arsimit të lartë të paktën gjysmën e kohës.
- Jeni 18 vjeç e lart dhe po frekuentoni shkollën e mesme të paktën gjysmën e kohës.
- Jeni regjistruar në W-2 dhe po veproni në përputhje me kërkesat e W-2-shit.
- Po punoni 30 a më shumë orë në javë ose po fitoni pagë të barabartë me 30 a më shumë orë në javë me pagën minimale federale.
- Jetoni në një zonë që përjashtohet nga papunësia ose jeni pjesëtar i një fisi autokton që jeton në një tokë autoktone apo në një rezervat që përjashtohet nga papunësia. Për të parë listën e zonave që përjashtohen nga papunësia si dhe të tokave apo rezervateve

autoktone shkoni në www.dhs.wisconsin.gov/fset/exemptions.htm.

Shënim: Mund t'ju duhet që të jepni prova që përbëni përjashtim.

Po në qoftë se nuk e plotësoj kriterin e punës?

Në qoftë se nevojitet që ta plotësoni kriterin e punës dhe nuk e plotësoni atë, përfitimet FoodShare mund t'ju kufizohen në tre muaj gjatë një periudhe prej 36 muajsh (tre vjetësh). Që të vazhdoni të merrni përfitimet FoodShare pas këtyre tre muajve, duhet të plotësoni kriterin e punës, të përbëni përjashtim, ose të prisni derisa periudha juaj 36-mujore të ketë kaluar.

Si mund të gjej ndihmë për të plotësuar kriterin e punës?

Do t'ju referojnë në programin FSET kur të rinovoni ose aplikoni për përfitimet FoodShare në qoftë se ju duhet të plotësoni kriterin e punës

dhe nuk po punoni ose merrni pjesë në një program pune për të paktën 80 orë çdo muaj ose një kombinim i të dyjave.

FSET mund t'ju ndihmojë që të plotësoni kriterin e punës. FSET ofron shërbime falas për t'ju ndihmuar që të fitoni aftësi pune dhe të gjeni punë.

Për më tepër informacion për FoodShare ose programin FSET:

- Shkoni te www.dhs.wisconsin.gov/foodshare/index.htm.
- Kontaktoni agjencinë tuaj vendore.

Për të gjetur agjencinë tuaj, shkoni te www.dhs.wisconsin.gov/forwardhealth/resources.htm, shikoni faqen 2 të kësaj fletushke, ose telefononi Shërbimin e Anëtarëve në numrin 800-362-3002 (Shërbimet teletekst TTY dhe të përkthimit janë të disponueshme).


Informacion kontakti për Income Maintenance Consortiums and Tribal Agencies

(Partneritetin e Ruajtjes së të Ardhurave dhe për Agjencitë Fisnore)

Partneritetet për ruajtjen e të ardhurave (të quajtura shpesh agjenci) dhe agjencitë fisnore mund t'ju ndihmojnë për sa u përket shërbimeve për pranimin në programe të tilla si, Medicaid, BadgerCare Plus dhe FoodShare. Në tabelën e mëposhtme janë renditur partneritetet për ruajtjen e të ardhurave dhe agjencitë fisnore, dhe në të janë përfshirë numra telefoni, si edhe qarqet që përbëjnë secilin partneritet. Nëse keni pyetje lidhur me pranueshmërinë ose rastin tuaj, telefononi partneritetin që përfaqëson qarkun ose agjencinë fisnore tuaj.

Bad River Band of Lake Superior Tribe of Chippewa Indians	715-682-7127
Bay Lake	888-794-5747
<ul style="list-style-type: none"> • Brown • Door • Marinette • Oconto • Shawano 	
Capital	888-794-5556
<ul style="list-style-type: none"> • Adams • Columbia • Dane • Dodge • Juneau • Richland • Sauk • Sheboygan 	
Central	888-445-1621
<ul style="list-style-type: none"> • Langlade • Marathon • Oneida • Portage 	
East Central Income Maintenance Partnership	888-256-4563
<ul style="list-style-type: none"> • Calumet • Green Lake • Kewaunee • Manitowoc • Marquette • Outagamie • Waupaca • Waushara • Winnebago 	
Forest County Potawatomi Community	715-478-4433
Great Rivers	888-283-0012
<ul style="list-style-type: none"> • Barron • Burnett • Chippewa • Douglas • Dunn • Eau Claire • Pierce • Polk • St. Croix • Washburn 	
Lac Courte Oreilles Band of Lake Superior Tribe of Chippewa Indians of Wisconsin	715-634-8934
Lac du Flambeau Band of Lake Superior Tribe of Chippewa Indians	715-588-4235
Menominee Indian Tribe of Wisconsin	715-799-5137
Milwaukee Enrollment Services (MIES)	888-947-6583
Milwaukee	
Moraine Lakes	888-446-1239
<ul style="list-style-type: none"> • Fond du Lac • Ozaukee • Walworth • Washington • Waukesha 	
Northern	888-794-5722
<ul style="list-style-type: none"> • Ashland • Bayfield • Florence • Forest • Iron • Lincoln • Price • Rusk • Sawyer • Taylor • Vilas • Wood 	
Oneida Nation	800-216-3216
Red Cliff Band of Lake Superior Chippewa	715-779-3706
Sokaogon Chippewa Community	715-478-3265
Southern	888-794-5780
<ul style="list-style-type: none"> • Crawford • Grant • Green • Iowa • Jefferson • Lafayette • Rock 	
Stockbridge-Munsee Community	715-793-4032
Western Region for Economic Assistance	888-627-0430
<ul style="list-style-type: none"> • Buffalo • Clark • Jackson • La Crosse • Monroe • Pepin • Trempealeau • Vernon 	
Wisconsin's Kenosha Racine Partnership (WKRP)	888-794-5820
<ul style="list-style-type: none"> • Kenosha • Racine 	

Harta e Partneriteteve për Ruajtjen e të Ardhurave dhe e Agjencie Fisnore



Deklaratë mosdiskrimini nga USDA-ja (Departamenti Amerikan i Agrikulturës)

Në përputhje me ligjin federal për të drejtat civile dhe rregullat e politikave të Departamentit Amerikan të Agrikulturës (U.S. Department of Agriculture, USDA) për të drejtat civile, USDA-ja, agjencitë, zyrtarët dhe punonjësit e saj dhe institucionet që administrojnë apo marrin pjesë në programet e USDA-së, nuk lejohen që të diskriminojnë në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, seksit, besimit fetar, paaftësisë, moshës, bindjeve politike ose të kryejnë shpallim apo hakmarrje për aktivitete të mëparshme për të drejtat civile në çfarëdo programi apo aktiviteti të kryer apo financuar nga USDA-ja.

Personat me paftësi që kanë nevojë për mjete të tjera komunikimi për të marrë informacion për programin (p.sh. shkrim Braj, me shkronja të mëdha, kasete, gjuhë amerikane me shenja etj.), duhet të kontaktojnë agjencinë (shtetërore ose lokale) ku aplikuan për përfitime. Individët që janë të shurdhër, nuk dëgjojnë mirë ose kanë paftësi në të folur mund ta kontaktojnë USDA-në nëpërmjet Shërbimit Federal Ndërmjetës në numrin (800) 877-8339. Përveç kësaj, informacioni për programin mund të jetë në dispozicion në gjuhë të tjera përveç anglishtes.

Për të bërë një ankesë diskriminimi për këtë program, plotësoni formularin [USDA Program Discrimination Complaint Form](https://www.ascr.usda.gov/filing-program-discrimination-complaint-usda-customer), (AD-3027) të cilin mund ta gjeni në internet te: <https://www.ascr.usda.gov/filing-program-discrimination-complaint-usda-customer> dhe në secilën zyrë të USDA-së ose shkruani një letër drejtuar USDA-së dhe shënoni në letër të gjithë informacionin që kërkohet në formular. Për të kërkuar një kopje të formularit të ankesës, telefononi numrin (866) 632-9992. Formularin e plotësuar ose letrën dërgojani USDA-së:

- (1) me postë: U.S. Department of Agriculture
Office of the Assistant Secretary for Civil Rights
1400 Independence Avenue, SW
Washington, D.C. 20250-9410;
- (2) me faks: (202) 690-7442; ose
- (3) me email: program.intake@usda.gov.

Ky institucion ofron mundësi të barabarta për të gjithë.